

V E N D I M
Nr.115, datë 21.3.1994

**PËR VLERËSIMIN E PASURISË MINERARE TË BASHKËSIVE EKONOMIKE DHE
NDËRMARRJEVE SHTETËRORE MINERARE**

Në zbatim të nenit 20 të ligjit mineral të Shqipërisë nr.7796, datë 17.2.1994, me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Vlerësimi i pasurisë së bashkësive ekonomike dhe ndërmarrjeve shtetërore minerare që marrin pjesë në një shoqëri tregtare ose që privatizohen të kryhet sipas këtyre metodikave:

a) Metoda e vlerësimit kohor të fluksit të parasë (Discounted Cash Flow Method- DCF).

- Metoda DCF e vlerësimit të pasurisë së bashkësive ekonomike dhe ndërmarrjeve shtetërore minerare bazohet në llogaritjen e fluksit të lirë të parave që do të realizohen në të ardhmen.

- Ky fluks parash i shperndarë në vite aktualizohet në vitin kur kryhet vlerësimi.

- Rezultati që merret është vlere e pasurisë së bashkësisë ekonomike ose ndërmarrjes shtetërore minerare, për të cilën është kryer vlerësimi.

b) Metoda e trasaksionit të krahasueshëm (Comparable Transaction Method).

- Metoda e transaksionit të krahasueshëm për vlerësimin e pasurisë së bashkësive ekonomike dhe ndërmarrjeve shtetërore minerare bazohet në analizën e transaksioneve të kryera për bashkësi ekonomike ose ndërmarrje të ngjashme me bashkësitë ekonomike ose ndërmarrjet në fjalë.

2.Ministri i Burimeve Minerare dhe Energjetike vendos për vlerën përfundimtare të vlerësimit të pasurisë minerare të bashkësive ekonomike dhe ndërmarrjeve shtetërore minerare, e cila mund të shërbejë si vlerë minimale e mundshme.

3. Për zbatimin këtij vendimi ngarkohet Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi